REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPKI
Nr. Prot. 06-01/75/21
Data 19.01.2021
03
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 14.01.2021, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. **Mbyllet rasti Nr. AKK-DPKI-06-1746/20, për zyrtarin z. Daut Thaqi, ish-Këshilltar i (ish) Ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

II. **Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.**

A r s y e t i m

I. Pas pranimit të informacionit të jashtëm nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, Agjencia kundër Korrupsionit ka hapur rastin me numër protokolli AKK-DPKI-06-1746/20, për ish zyrtarin e lartë z. Daut Thaqi, duke zhvilluar procedurën e paparë sipas Ligjit nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia kundër Korrupsionit ka filluar trajtimin e rastit lidhur me gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, pas pranimit të informatës nga një palë e tretë *(shkresa nr.: DPKI-06-1746/20)*, me pretendimin për konflikt të interesit me rastin e punësimit të z. Daut Thaqi, në pozitën '*Zyrtar i Lartë për Integrime të Komuniteteve*' në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (në vijim: MKRS), duke marr parasysh se i njëjti ka qenë Këshilltar i (ish) Ministrit në MKRS.

Agjencia kundër Korrupsionit konform mandatit që ka, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, fillimisht ka bërë verifikimin dhe konfirmimin e informacionit të mësipërm në institucionet përkatëse sa i përket funksionit publik të ish zyrtarit të lartë në fjalë (*DPKI-06-01/2637/20*).

Në këndvështrim të situatës së referuar më sipër për konflikt të mundshëm të interesit, Agjencia kundër Korrupsionit, ka shqyrtuar dokumentacionin në dispozicion si dhe përveç Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka konsultuar aktet tjera relevante ligjore dhe nënligjore, përfshirë dhe kodet respektive të etikës lidhur me rastin në fjalë.

Me theks të veçantë janë shqyrtuar dhe analizuar dispozitat e nenit 18 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ku janë paraparë kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike.

Në këtë mënyrë, me paragrafin 1, nën-paragrafi 1.1, të këtij neni është përcaktuar se:

"1. Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë: 1.1. të punësohet ose të emërohet, për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozitë udhëheqëse ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe institucioneve vartëse të tyre të cilat kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të tyre; [...]"

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion të Agjencisë kundër Korrupsionit si dhe dispozitës së sipërcituar, rezulton se ish zyrtari i lartë, z. Daut Thaqi, i cili ka qenë i punësuar si *Këshilltar* i (ish) Ministrit të MKRS-së, me rastin e punësimit të tij si *Zyrtar i Lartë për Integrime të Komuniteteve* në MKRS, në bazë të *Akt Emërimit*, përkatësisht *Përshkrimit të Detyrave të Punës* së tij, kjo pozitë nuk është *pozitë udhëheqëse apo menaxhuese,* por pozitë e '*Nivelit profesional*' në shërbimin civil. Gjithashtu, nuk ekziston një lidhje hierarkike në kuptim *të mbikëqyrjes, kontrollit apo sanksionimit të drejtpërdrejtë* midis këtyre pozitave, përkatësisht pozitës së *Këshilltarit* të Ministrit dhe pozitës së *Zyrtarit të Lartë për Integrime të Komuniteteve* në MKRS.

Prandaj, duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar mësipër, Agjencia kundër Korrupsionit konstatoi se punësimi i z. Daut Thaqit në pozitën '*Zyrtar i Lartë për Integrime të Komuniteteve*' në shërbimin civil në MKRS, duke marr parasysh se i njëjti ka qenë *Këshilltar* i (ish) Ministrit të MKRS-së, nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 18, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, për faktin se, siç u tha më lartë, pozita në të cilën është punësuar z. Daut Thaqi si *Zyrtar i Lartë për Integrime të Komuniteteve* në MKRS, nuk është *pozitë udhëheqëse apo menaxhuese*, e as nuk ekziston një lidhje hierarkike në kuptim *të mbikëqyrjes, kontrollit apo sanksionimit të drejtpërdrejtë* midis këtyre pozitave brenda MKRS-së.

Kështu që, kufizimet e zyrtarit të lartë publik pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike sipas nenit 18, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nuk vlejnë në rastin e punësimit të z. Daut Thaqi në pozitën *Zyrtar i Lartë për Integrime të Komuniteteve* në MKRS.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159, për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit